



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 10412/7661/3327(31010-04247-86-2015) Regjistri
Datë 16.06.2015 regjistrimi

Nr. 3622 Vendimi
Datë 12.09.2017

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesues: Arjan Qafa
Anëtare: Alkelina Gazidedja
Anëtare: Enkelejda Metaliaj(Softa)

-asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED] në Tiranë në datë 12.09.2017 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me Nr. 10412/7661/3327(31010-04247-86-2015) Regjistri, datë 16.06.2015 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: Ministria e Arsimit dhe Sportit.

TË PADITUR: Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PERSON I TRETE: Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë.

OBJEKTI: Mase sigurimi padie per pezullimin e ekzekutimit te Vendimit Nr.14, date 29.01.2015 i Komisionerit per Mbrojtje nga Diskriminimi.

Shfuqizimin e aktit administrativ si te papajtueshem me ligjin, Vendim Nr. 14, date 29.01.2015 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

BAZA LIGJORE: Neni 10 i Kushtetutes se Shqiperise, neni 137 e vijues te Kodit te Procedures Administrative, neni 153, 154, 155,156 dhe neni 202 e vijues te Kodit te Procedures Civile, neni 15,16,17,28,29,30 i Ligjit nr. 49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative, i ndryshuar, neni 7 i Ligjit nr.

69/2012 "Per arsimin parauniversitar ne Republiken e Shqiperise" dhe Ligji nr. 10221/2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin Nr. 2665, datë 18.05.2015 ka vendosur:

- *Rrezimin e kerkese padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të pales paditese.*
- *Kundër ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Administrativ Tirane brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme e marrjes dijeni per kete vendim.*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala paditese, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kerkese padise, duke parashtruar këto pretendime:

- Shteti shqiptar me nenin 10 të Kushtetutës distancohet nga favorizimi i një feje të caktuar duke i trajtuar të gjitha njësoj, dhe vetë rëndësia që paraqet fakti i theksimit që: "*Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare*", e bën këtë parim të rëndësishëm jo vetëm që të përmendet që në Kushtetutë, në ligjin themelor, më të lartë të vendit, prej nga burojnë edhe ligjet e tjera, por edhe të renditet në nenet e para të Kushtetutës, pikërisht aty ku renditen dhe trajtohen edhe parimet themelore të ndërtimit të shtetit të drejtës.
- Vetë renditja në Kushtetutë dhe trajtimi i çështjeve fetare (si parime themelore) duke iu kushtuar një nen të veçantë në Kushtetutë, siç është neni 10, na bën të vlerësojmë se ky parim "*Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare*", të mbrohet me rigorozitet në çdo akt ligjor dhe nënligjor të mëtejshëm që del në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Po ashtu në nenin 10/4 të Kushtetutës parashikohet se: "*Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellët pavarësinë e njëri-tjetrit*", pra shteti dhe bashkësitë fetare jetojnë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin, me kushtin që të respektojnë pavarësinë e tyre, pa ndërhyrje reciproke për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre, por deri në atë masë që parashikon Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi.
- Nga ana tjetër në nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës parashikohet dhe garantohet liria e shprehjes, edhe në jetën publike, si dhe liria e ndërgjegjes dhe e fesë. Megjithatë në konkurrimin e këtyre parimeve, prej të cilave rrjedhin të drejta dhe detyrime të caktuara, merr prioritet fakti që: "*Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare*" dhe pavarësisht se Kushtetuta garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë, kjo e fundit lind dhe zhvillohet deri në masën që nuk cenon një ndër parimet bazë të shtetit të së drejtës që në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. Në nenin

24/2 Kushtetuta parashikohet se: "*Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve*", por kur themi jetë publike nënkuptohet shprehja e lirshme e besimit në aktivitete të organizuara prej Organizatave Fetare apo hapjen dhe mbylljen e institucioneve fetare, fakt që nuk tregon se lejohet drejtpërdrejt apo tërthorazi shprehja e besimit fetar në Institucione Shtetërore që me rregull dhe ligj janë Laike dhe me rregullore e ndalojnë shfaqjen hapur të besimit fetar. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh në neni 7 i Ligjit nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

- Në rastin objekt gjykimi sqarojmë se Shkolla [REDAKTUAR], Pogradec, nuk është një shkollë private e hapur nga organizatat apo bashkësitë fetare, por është një shkollë shtetërore, publike dhe si e tillë, ajo ka detyrimin të respektojë nenin 10 të Kushtetutës, nenin 7 të Ligjit 69/2012 mbi laicitetin e institucionit arsimor dhe pikën j), të nenit 41 të Dispozitave Normative ku thuhet se "*Veshja dhe paraqitja e tij të jetë korrekte, pa teprime, e përshatshme me moshën që ai (nxënësi) ka, në përputhje me kërkesat e normat e bashkëjetesës në shoqëri dhe me rregulloren e brendshme të shkollës*". Pra me një interpretim të gjerë të kombinuar të këtyre dy normave duke e vendosur dhe në kontekstin për të cilën po diskutohet, bëjmë me dije se sipas këtyre normave askush nuk lejohet të shfaqë bindjet fetare nëpërmjet veshjes apo në çdo formë tjetër brenda ambienteve të një institucioni që me ligj është laik dhe synon dhe promovon barazinë mes nxënësve duke filluar nga veshja. Rregullorja e brendshme e shkollës duhet të përcaktojë normat e veshjes. Në rast se nuk ka rregullore të miratuar zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat normative, të miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, të cilat përcaktojnë se veshja duhet të jete në përputhje me normat e bashkëjetesës, ku në një ambient laik, veshja duhet të jetë laike.
- Ky qëndrim i shkollës është i bazuar në dispozitat Kushtetuese, në ligj, në akte nënligjore dhe në asnjë rast nuk shkel të drejtat e personit për ushtrimin e fesë, sepse vetë Kushtetuta garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë, por pa cenuar laicitetin e shkollave publike, shtetërore.
- Në bazë të ligjit si më lart, Shkolla Publike [REDAKTUAR] duhet të respektojë laicitetin e institucionit arsimor publik dhe duhet të marrë masa për zbatim të tij duke paralajmëruar për këtë çdo nxënësi, punonjës mësimor apo të administrates që të zbatohet ky parim i sanksionuar me ligj. Në rast të kundërt për shkelësit e nenit 7, nenit 56 (pika 3 shkronja d) dhe nenit 61 të Ligjit 69/2012 (pika 2 shkronja d) si dhe Dispozitave Normative duhet të merren masa të parashikuara në këtë ligj dhe në dispozitat normative të nxjerra për zbatim të tij.

- Ministria e Arsimit dhe Sportit e kundërshton vendimin nr. 14, datë 29.01.2015 të Komisionerit për Diskriminimin, i cili konstaton se në rastin e nxënëses Joana Rexhollari është ushtruar diskriminim i drejtpërdrejtë në fushën e arsimit, për shkak të bindjeve fetare, kjo për faktin se nxënësja mëson në një shkollë publike, ku në bazë të ligjit duhet të veprojë parimi i laicitetit dhe në bazë të rregullores së brendshme të shkollës veshja e nxënëses duhet të jetë e përshtatshme që mos të tregojë shenjë të cenimit të këtij parimi. Nga ana tjetër theksojmë se shteti nuk i ka penguar aspak ata persona që kërkojnë të zhvillojnë dijet dhe arsimin e tyre ku mund të shprehin dhe zhvillojnë bindjet fetare, pasi për sa parashikohet në Kushtetutë, por edhe në nenin 42 të Ligjit nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", shteti bën rregullimin ligjor dhe krijon mundësinë efektive të hapjes së institucioneve arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare, ose që themelohen apo administrohen nga bashkësitë fetare.
- Këto institucione private hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesve të bashkësive fetare. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Pra nëse nxënësja [REDAKTUAR] kërkon të arsimohet në një shkollë ku mund të shprehë dhe të zhvillojë idetë e saj fetare, dhe të përdorë veshje që i përshtaten këtyre bindjeve, ato mund t'i shprehë nëpërmjet arsimimit në shkolla private, të përshtatshme fetare, pa cenuar bindjet e saj, por nëse qëndron kërkesa e saj për tu shkolluar në shkolla publike, atëherë ky arsimim duhet të kushtëzohet nga detyrimet ligjore që parashikohen për shkollat publike, ku sundon parimi i laicitetit të tyre.
- Gjithashtu theksojmë se nxënësja [REDAKTUAR] nuk i mohohet e drejta e besimit apo e studimit në një shkollë të mesme, pasi shkolla e mesme është e hapur për të gjithë, por ajo është identifikuar si një nxënësve që ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të ligjit 69/2012 për Arsimin Parauniversitar, dhe si c tillë u paralajmërua për largimin nga shkolla nëse nuk respekton këtë parim ligjor. Për këtë qëllim u mor edhe masa konkrete, si rezultat i mosrespektimit nga ana e saj të parimit të laicitetit. Por në qoftë se do të vendoset prej saj dhe familjarëve pushimi i cenimit të këtij ligji, në nenin 7 të tij, duke e zbatuar atë, Dispozitat Normative si dhe rregulloren e shkollës, ajo do të pranohet normalisht në shkollë.
- Theksojmë në këtë pikë se dispozita ligjore për parashikimin dhe respektimin e parimit të laicitetit në shkolla publike, shtetërore është parashikuar shumë kohë më parë se kjo nxënësja të regjistrohej në këtë shkollë, dhe nxënësja kishte detyrimin ligjor të njëjtit ligjin dhe rregulloren e brendshme të shkollës para se të vepronte me përdorimin e simboleve fetare që do të krijonte

një impakt negativ, edhe të nxënës të tjerë që janë regjistruar për arsimim në një shkollë publike jo fetare. Ndonëse siç Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi, në vendimin e tij, thekson se interesi i nxënësit është parësor (neni 61 Ligjit nr. 69/2012), në këtë rast jo vetëm që nuk cenohet interesi i nxënësit, sepse legjislacioni, por edhe praktika ia lejon mundësinë e arsimimit në shkolla private, fetare, pa cenuar aspak të drejtën për arsimim, por edhe duhet të mbahet në konsideratë se interesi i nxënësit është parësor kur nuk cenohen kushtet ligjore, por edhe interesi i nxënësve të tjerë, të cilët kanë janë regjistruar për tu arsimuar në shkolla publike, laike, jashtë përdorimit të simboleve fetare.

- Për sa më sipër konsiderojmë që Vendimi Nr.14, datë 29.01.2015 i Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi, vjen në kundërshtim me:
 1. Pikën 1 të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilën përcaktohet se: *"Të gjithë janë të barnbartë përpara ligjit"*.
 2. Pikën "a" të nenit 2 të Ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të cilën përcaktohet se: *"Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji"*.
 3. Nenin 7 të ligjit nr.69/2012 "Për arsimin parauniversitar", i cili përcakton se: *"Arsimi parauniversitar është laik. Përjashtim bëjnë ato institucione arsimore që themelohen nga bashkësi fetare të njohura me ligj, sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 4 të këtij ligji"* dhe germën "d" të pikës 2 të nenit 61 në të cilën përcaktohet se: *Nxënësi ka detyrë të respektojë rregulloren e institucionit*.
 4. Germën "j" të pikës 1 të nenit 40 të Dispozitave Normative, ku përcaktohet se: *"j) Veshja dhe paraqitjen e tij të jetë korrekte, pa teprime, e përshtatshme me moshën që ai ka, në përputhje me kërkesat e normat e bashkëjetesës në shoqëri dhe me rregulloren e brendshme të shkollës"*.
 5. Udhëzimit të Ministrit të MASH nr.30, datë 02.08.2013 "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore", ku në pikën 7 të kreut II, përcaktohet se: *"Institucioni arsimor, duhet të përcaktojë veshjen dhe uniformën e nxënësve në institucion"*.
 6. Rregullores së Brendshme të Gjimnazit "██████████" 2014-2015, në të cilën përcaktohet se: *"Veshja e tij të jetë korrekte, pa teprime, e përshtatshme për moshën që ka dhe të respektojë ambientin laik të shkollës"*.
- Kuadri ligjor në fuqi për arsimin parauniversitar, ka përcaktuar rregulla të qarta për të gjithë

nxënësit dhe këto rregulla duhet të respektohen nga të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë, si kërkesë themelore kushtetuese, që të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, ndërsa vendimi Nr.14, datë 29.01.2015 i Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi, e cenon këtë barazi duke i njohur të drejta të veçanta një nxënësi. Në analizë të fakteve të çështjes konsiderojmë që, laiciteti e merr dimensionin e plotë si nga përmbajtja e kurrikulës, që është plotësisht laike ashtu edhe nga forma, element parësor i së cilës është edhe etika e veshjes.

- Kjo etikë e veshjes, është shprehur në uniforma për nxënësit dhe përparëse për mësuesit e arsimit parauniversitar, gjë e cila është përcaktuar në rregulloret e tyre të brendshme.
- Respektimi të të drejtave kushtetuese, të cilat "*sui generis*", janë të drejta dhe liri të vendosura me konsensusin e të gjithë anëtarëve të shoqërisë dhe të sanksionuara pozitivisht, nuk nënkupton lirinë individuale absolute (anarkinë), e cila nuk mund të ekzistojë në qytetërimet moderne. Liria dhe autonomia janë koncepte relacioni, që përcaktohen nga rendi juridik të cilave iu përkasin. Ato i gjejnë përmasat dhe kufijtë e tyre lidhur me lirinë dhe autonominë e subjekteve të tjera dhe me interesin e përgjithshëm të të gjithë shoqërisë.
- Në vitin 2005, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, në vendimin mbi çështjen "*Leyla v. Turqi*", i dha të drejtë shtetit turk në ndalimin që ky i fundit i kishte bërë kërkueses të sipërpërmendur për të hyrë në ambientet shkollore me kokën të mbuluar me shami (ndalimi ishte edhe për djemtë me mjekër, kur kjo e fundit konsiderohej si simbol fetar). Gjykata theksoi se kufizimi ishte i bazuar tek parimi i shekullarizimit (laicitetit) dhe i barazisë. Shekullarizmi, si garantues i parimeve demokratike, është pika e takimit midis lirisë dhe barazisë. Ky parim e pengon shtetin që të manifestojë pretencën e tij ndaj një besimi të caktuar fetar, për pasojë ai e udhëheq shtetin në rolin e tij si arbitër i paanshëm dhe detyrimisht mundëson lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes.
- Ndonëse siç e theksuam që në fillim, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk i është vënë ende në dispozicion një kopje e vendimit, por nisur rrethanat e çështjes gjatë gjykimit, kundërshtojmë vendimin e Gjykatës, kur pretendon se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund të depozitonte kërkesë-padi në gjykatë ndaj vendimit të Komisionerit, pasi këtë tagër mund ta ushtronte vetëm Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë. Ky kundërshtim vjen për faktin se, theksojmë, MAS është organ epror i Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, dhe mund të veprojë në emër dhe për llogari të saj në çdo rast kur e sheh të nevojshme për ndërhyrje në zgjidhjen më të mirë të situatës, po ashtu, me Vendimin nr.14 datë 29.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. theksojmë se ngarkohej edhe MAS me marrjen e masave të caktuara për të rregulluar legjislacionin në fuqi, pas konstatimit të bërë nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga

Diskriminimi për konsiderimin si diskriminim të realizuar ndaj shtetases Joana Rexhollari. Kjo e fundit lidhet për më tepër me faktin që MAS duhet të ndërhynte, dhe për të realizuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi kundërshtimin ndaj vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, reagoi me depozitimin e kërkesë-padisë para gjykatës kompetente.

- Nga ana tjetër sqarojmë se për të qenë pjesë e këtij procesi gjyqësor të rëndësishëm që krijon një impakt të fortë te nxënësit, mësuesit dhe të gjithë aktorët e tjerë që lidhen me fushën e arsimit, të shpjeguar gjerësisht edhe më lart, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kërkuar thirrjen në cilësinë e personit të tretë edhe Drejtorinë Arsimore Rajonale Korçë, kërkesë e cila u pranua edhe nga gjykata, e cila do të shërbente në sqarimin e mëtejshëm të rrethanave dhe që siç rezultoi edhe gjatë gjykimit ishte në qëndrimin unison me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në kundërshtimin e përbashkët të Vendimit nr.14 datë 29.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi .
- Në përfundim konsiderojmë se prej shkollës nuk është treguar asnjë shkelje e Ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", por përkundrazi prej shkollës është respektuar me rigorozitet neni 7 i Ligjit 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar" dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
- Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi, në vendimin e tij, nuk ka marrë parasysh aspak këtë normë ligjore të rëndësishme, nenin 7 të Ligjit 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", ku trajtohet parimi i laicitetit në shkolla publike.
- Vendimi nr. 14, datë 29.01.2015 duhet të dilte vetëm pasi të viheshin në balancë të gjitha parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe të shihej më konkretisht se cila dispozitë ligjore apo e akteve nënligjore është shkelur nga shkolla, duke patur parasysh interesin publik të përgjithshëm

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari Arjan Qafa, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të ankimit të bërë nga pala paditëse.

Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentave, kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se vendimi nr. 2665, datë 18.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është i drejtë dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Vendimi objekt ankimi është rrjedhojë e analizës së drejtë të provave dhe zbatimit korrekt të ligjit, për rrjedhojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala paditëse për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesë padisë, nuk qëndrojnë.

Kolegji, ndryshe nga sa pretendon pala paditëse në ankim, konkludon se gjykata në vendimin e saj objekt shqyrtimi në apel administrativ, i ka dhënë përgjigje gjithë kërkimeve dhe prapësimeve të palëve në proces.

I. Rrethanat e çështjes:

Nga provat e administruara ka rezultuar se, me vendimin me nr .14 datë 29/01/2015 pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim kërkesën e nxënëses Rexhollari me objekt pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve fetare.

Nxënësjja [REDACTED] ndjek sistemimim arsimor në klasën e 10 -të në Shkollën e Mesme të Përgjithshme [REDACTED] gjatë vitit shkollor 2013 - 2014. Nxënësjja [REDACTED] përket besimit musliman dhe në fillim të vitit 2013- 2014 ajo ka vendosur mbulesë element ky që i përket besimit të saj.

Nxënësjja [REDACTED] në këto kushte është paraqitur me mbulesë edhe në ambjentet e shkollës por ajo është ndaluar të hyjë në ambjentet e shkollës me mbulesë nga stafi i shkollës.

Si rrjedhojë nxënësjja [REDACTED] është ankuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pas kryerjes së hetimit administrativ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konkludoi se nga ana e Drejtorisë Arsimore Korçë - Shkollës së Mesme së Përgjithëshme [REDACTED] është kryer diskriminimi për shkak të bindjes fetare përkundrejtë nxënëses [REDACTED] dhe ndalimin e menjëhershëm të këtij diskriminimi duke lejuar nxënësen [REDACTED] të ndjek eeurinë mësimore me të njëjtin nivel si nxënësit e tjerë.

Gjithashtu në këtë vendimarrje është rekomanduar Ministria e Arsimit dhe Sportit që të amendojë ligjin për sistemiminn parauniversitar për të hartuar akte ligjore dhe nënligjore më të sakta dhe më të qarta.

Pala paditese, duke mos gjetur duke mos qene dakort me kete vendimarrje, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi.

II. Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane:

Në analizë të pretendimeve të parashtuara në kërkesë padi, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata ka vlerësuar se, padia e paraqitur prej paditëses është e pabazuar në ligj, ndaj ka disponuar me rrezimin e saj.

Gjykata ka konkluduar se kjo kërkesë padi shfaqë problematikë të saj në dy drejtime kryesore. Përkatësisht nga gjykimi rezultoi se pala paditëse nuk ka legjitimitet aktiv në paraqitjen e kësaj padie dhe për më tepër sjellja e organeve të arsimit parauniversitar të administruara në hierarkinë e tyre nga Drejtoria Rajonale Korçë është jo në përputhje me ligjin, ka prodhuar diskriminim dhe Vendimi objekt atakimi në këtë gjykim është i ligjshëm. Respektivisht gjykata në argumentimin e saj ju dha përgjigje këtyre çështjeve juridike.

Gjykata ka vlerësuar se padia për të kërkuar shfuqizimin e një akti administrativ paraqitet për të kundërshtuar një akt relativisht të pavlefshëm. (jo akt absolutisht i pavlefshëm). Pra logjika që ndjek ligji 49/2012 është ajo e pasjes se një interesi të ligjshëm apo të drejtë të cënuar të cilën subjekti paditës kërkon ta rivendosë nëpërmjet kësaj padie. Pasja e një interesi të ligjshëm në ngritjen e padisë është një kusht thelbësor për legjitimitetin e paditësit. "Barra e proves" për të provuar pasjen e legjitimitetit aktiv në ngritjen e padisë mbetet e pales paditëse që është edhe pala që e inicion këtë gjykim. Pala paditëse që është pala që kërkon shfuqizimin e aktit është edhe pala që mbart detyrimin për të provuar lidhjen e drejtëpërdrejtë ndërmjet interesit të pretenduar dhe aktit që kundërshtohet. Duke iu referuar rregullave procedurale palës në gjykim administrativ janë subjektet në emër ose kundër të cilave zhvillohet gjykimi. Pra pjesëmarrës është subjekti që është mbajtës i të drejtave dhe interesave të ligjshëm me kërkesën e të cilit fillon procesi ose kundër të cilit zhvillohet procesi. Në procesin gjyqësor administrativ për të legjitimuar veten palës i kërkohet të provojë interesin e saj të ligjshëm në çështjen në shqyrtim. Koncepti i interesit të ligjshëm dhe legjitimiteti i palës janë dy koncepte në funksion të njëri tjetrit.

Interesi i ligjshëm padyshim duhet të jetë një interes aktual, konkret i sigurtë dhe drejtëpërdrejtë për paditësin. Pra një nga kushtet e pasjes së interesit të ligjshëm është edhe pasja e një interesi të drejtëpërdrejtë në atë çka kërkohet nga paditësi. Interesi i drejtëpërdrejtë dhe harku i konceptimit të tij është i lidhur edhe me llojin e padisë. Pasi tek padia shfuqizuese interesi i palës private konsiderohet dhe duhet të jetë i lidhur drejtëpërdrejtë me aktin që shfuqizohet dhe me pasojat juridike që ai prodhon. Legjitimiteti në këto raste varet nga cënimi i drejtëpërdrejtë i të drejtës subjektive të paditësit. Çka do të thotë se paditës zakonisht do të jetë subjekti që i

drejtohet a-kti administrativ përkundrejtë të cilit vjen pasoja juridike dhe mbrojta e këtij subjekti vjen përkundrejtë shfuqizimit të aktit.

Gjykata ka cmuar se, pala paditëse nuk e plotëson këtë kriter në rastin konkret pasi pala paditëse kërkon të shfuqizojë një akt administrativ që nuk i drejtohet asaj apo nuk prodhon pasoja juridike për të. Kjo palë nuk ka një interes të drejtëpërdrejtë në goditjen e këtij akti administrativ. Pasi realisht ky akt në të gjithë përmbajtjen e tij dhe në mënyrë të vecante në pjesën urdhëruese të tij nuk sjell asnjë pasojë juridike konkrete për palën paditëse. Respektivisht duhet të theksohet se është konstatuar sjellje diskriminuese jo e palës paditëse por e organeve të administrates së sistemit parauniversitar me personalitet juridik të përqëndruar në Drejtorinë Rajonale Arsimore respektive (subjekt ky i thirrur me cilësinë e personit të tretë).

Gjykata ka vlerësuar se, në lidhje me palën paditëse është dhënë një rekomandim i cili duke u vlerësuar në raport me peshën e tij juridike nuk rezulton të ketë potencialin për të prodhuar pasoja juridike por as edhe nuk ka sjellë pasoja juridike.

Në Ligjin nr. 49/2012 jepet koncepti i aktit administrativ individual, i cili është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualsht të përeaktuara të së drejtës, që krijojnë, ndryshojnë ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Në momentin që pala paditëse kërkon të mbrohet me padinë e shfuqizimit të aktit, duhet të provojë kush është pasoja e drejtëpërdrejtë që i vjen kësaj pale nga ky akt individual i drejtuar një tjetër subjekti. Cila është pasoja që i ka ardhur palës paditëse në këtë rast. Asnjë pasojë konkrete. Sa më lartë gjykata ka konkluduar se, pala paditëse nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie përkundrejtë vendimit me nr. 14/viti 2015 të marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjykata ka vlerësuar se Vendimi me nr. 14 / viti 2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është atakuar në Gjykatën Administrative me qëllim të verifikimit të sjelljes së palës paditur në raport me atë eka ligji parashikon. Prandaj gjykata tërheqë vëmendjen e palëve se duke vlerësuar edhe mënyrën e funksionimit të palës së paditur qëllimi i këtij gjykimi është verifikimi i sjelljes së palës së paditur në raport me palën paditëse. Si rrjedhojë në cdo rast dhe për cdo lloj arsye kjo është një padi me objekt shfuqizimin e një akti administrativ individual që kërkon dhe realisht ka sjellë debat gjyqësorë nëpërmjet palës autoritet të nxjerrjes së këtij akti dhe palës që i drejtohet ky akt Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë (organi hierarkik dhe mbajtës i personalitetit juridik në sjelljen përgjatë të cilës është konstatuar diskriminim) si dhe ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si pala paditëse dhe iniciuese e këtij gjykimi. Duhet të theksohet se në rastin konkret shkaku ligjor i ngritjes së padisë nuk është marrëdhënia juridike

individuale e lindur dhe e zhvilluar ndërmjet subjektit të diskriminuar dhe palës së paditur. Kjo është një marrdhënie juridike e ngritur për shkak të vendimarrjes së palës së paditur e cila sipas palës paditëse ka sjellë pasoja . Si rrjedhojë në këtë lloj gjykimi do të vlerësohet sjellja e palës së paditur në raport me pasojën e menduar si të ardhur për palën që i drejtohet dhe për shkak të mënyrës jo të drejtë të ngritur të padisë pa legjitimitet edhe të palës paditëse.

Gjykata ka theksuar se rrethanat faktike janë rrethana të pakontestuar nga asnjë nga palët në gjykim, ajo që sjellë debat mes palëve ndërgjyqëse është mënyra e interpretimit të kuadrit ligjor në fuqi në raport, me atë cka ka ndodhur realisht.

Gjykata ka konstatuar se, në çështjen objekt gjykimi të gjitha palët pjesëmarrëse në gjykim pranojnë se në rastin konkret nga organet e arsimit parauniversitar ka patur ndalim të shprehjes apo shfaqjes në mjediset e shkollës së elemnteve të besimit mysliman nga nxënësja Rexhollari. Sipas nenit 18 të Kushtetutës, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafm e dytë, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

Gjykata, Kushtetuese nëpërmjet jurisprudences së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.

Në rastin e nxënësja [REDAKTUAR] asaj i është ndaluar ndjekja e ciklit mësimorë në një shkollë publike ku e drejta për arsim është e drejtë që iu përket të gjithë shtetasve shqiptar. Në këtë moment ndaj saj është bërë një sjellje diskriminuese. Në kuadër të vazhdimit të kësaj sjellje nga organet e arsimit parauniversitar është konkluduar se shkak i kësaj sjellje ndaj paditëses është fakti se ajo ka vënë mbulesë/ element i jashtëm i shfaqjes së besimit respektiv të praktikuar nga paditësja atij musliman.

Duke patur parasysh se nga palët ndërgjyqëse pranohet fakti se nxënësja [REDAKTUAR] është ndaluar të ndjekë mësimin të drejtë të barabartë për këdo shtetas shqiptar pikërisht për shkak se ajo ka shfaqur element të dukshëm të jashtëm si është edhe mbulesa të besimit musliman. Pra sjellja faktike bazë e diskriminimit është edhe motiv për çështje të besimit fetar është prezent

dhe nuk kontestohet.

Gjykata ka vlerësuar se, ajo që është objekt debati gjyqësor mes palëve ndërgjyqëse është fakti nëse kjo sjellje e organeve menaxhuese të arsimit parauniversitar (per shkak të mënyrës së ndërtimit jo të duhur të padisë, ato nuk janë palë paditëse në këtë gjykim) a është e ligjshme dhe ka mbështetje në ligj. Pra a njihet nga ligji mundësia e kulizimit të shfaqjes në ambjent e shkollës shterore/ publike të elementeve të një besimit fetar i cili të justifikojë edhe sjelljen diskriminuese ndaj subjektit respektiv duke i mohuar atij ndjekjen e ciklit respektiv arsimor dhe trajtimin e tij të barabartë. Pra sjellja e organeve menaxhuese dhe përgjegjëse të arsimit parauniversitar në raport me nxënësen kanë prodhuar një sjellje diskriminuese ndaj saj pasi e kanë ndaluar atë në të drejtën e saj për arsim e drejtë e barabartë për të gjithë, me argumentin se ajo shfaq element të jashtëm të besimit të saj fetar ku dhe e drejta për besim është e drejtë e barabartë për tu respektuar ndaj të gjithëve.

Gjykata ka cmuar se, pala paditëse dhe e personi i tretë pretendojnë se kjo sjellje e organeve menaxhuese dhe drejtuese të arsimit parauniversitar është jo diskriminuese pasi ekuilibri midis të drejtës për arsim në një shkollë publike dhe të drejtës për të shfaqur besimin fetar në mjediset e një shkollë publike është e normuar me ligj. Ku po sipas këtyre palëve kufizimi i shfaqjes në ambjentet e një shkolle publike të elementeve të një besimi të caktuar fetar si në rastin konkret të atij musliman është i lejuar nga ligji. Por pikërisht në lidhje me këtë moment nga gjykimi rezultoi se ky pretendim i palës paditëse dhe personit të tretë nuk është i vërtetë dhe i bazuar në ligj. Në nenin 10 të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, parashikohet se ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve. Pikërisht duke i kërkuar nxënëses që ndiqte arsimin parauniversitar, heqjen e mbulesës, element ky i shfaqjes së besimit musliman në mënyrë që ajo të ndiqte këtë cikël mësimor në vetvete asaj i është ndërhyrë në të drejtën e saj për ushtruar lirinë e fesë. Në një kohë që ky fakt pranohet pala paditëse dhe personi i tretë pretendojnë ligjshmëri në sjelljen e tyre por ky pretendim nuk rezultoi pasi përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminimin. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të cenon thelbin e lirisë dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të

tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata ka vlerësuar se, nga interpretimi i të gjithë ligjit për arsimin parauniversitar nuk rezulton asnjë dispozitë ligjore që pikërisht ligjëron këtë kufizim të shfaqjes në publik të elementeve të besimit që praktikon. Në një moment që ligji nuk parashikon dhe nuk normon raportin ndërmjet asaj që quhet laike dhe asaj që quhet veshje e përshtatshme për një nxënëse të arsimit parauniversitar. Mungesa e parashikimit konkret në ligj e ketij ndalimi dhe mungesa e një rregullore konkrete që të etiketojë dhe normojë këtë moment bëjnë të paqartë kufizimin me ligj të kësaj të drejte themelore.

Gjykata ka cmuar se, vendimarrja konkrete e palës së paditur në vendimin e saj nr. 14 të vitit 2015 është një vendimarrje e bazuar në ligj. Gjykata duke vlerësuar faktin se palës paditëse në këtë gjykim i mungon legjitimitimi aktiv, ka vlerësuar se ky argumentim duhet të ndalet këtu, pasi është e drejta e kujtdo subjekti që mendon se është cënuar nga kjo vendimarrje për tu gjykuar nga një gjykatë kompetente dhe të marrë në shqyrtim të gjithë elementët faktik dhe ligjor, si dhe pozicionimin e subjekteve në mënyrë të pavarur nga ajo cka kjo gjykatë gjykon. Në cdo rast ky argumentim i shërben vetëm gjykimin te drejtë dhe në themel të pretendimeve të palës paditëse.

Gjykata në përfundim të kësaj analize ligjore të fakteve objekt verifikimi duke vlerësuar kërkimet e palës paditëse, prapsimet e palës së paditur, raportin shkaku ligjor - bazë juridike objekt kërkimesh pasi çmoi provat e marra në gjykim vendos të rrezojë kërkesë - padinë si të bazuar në ligj dhe në prova.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Në analizë të ankimit të paraqitur nga pala paditëse, ndaj vendimit objekt ankimi dhe në analizë të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 2665, datë 18.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe atij material dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

1. Së pari, Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi, në referim të nenit 7 gërma "a", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

2. Së dyti, Gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 18.05.2015. Pala paditëse ka paraqitur ankim në datën 02.06.2015, pra dukshëm brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të K.Pr.Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012, që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankim, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata çmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit nr. 2665, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

3. Së treti lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim nga pala paditëse, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në këto pretendime rezulton të jenë paraqitur të njëjtat fakte dhe argumenta që janë paraqitur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe asnjë argument shtesë se përse analiza e rrethanave të faktit të bërë në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është e pabazuar në ligj e prova. Kolegji në bazë të nenit 17/2 të ligjit nr 49/2012 i zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme, duke iu bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët në rastin konkret paditësi në padinë e tij.

4. Gjykata Administrative e Apelit, në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi, arrin në konkluzione të ndryshme nga kjo gjykatë për sa i përket legjitimitetit aktiv të palës paditëse. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë se Ministria e Arsimit nuk ka legjitimitet aktiv në ngritjen e kësaj padie, pasi nuk provohet interesi i drejtpërdrejtë i kësaj pale në goditjen e aktit objekt gjykimi. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të theksojë se pasja e një interesi të ligjshëm në ngritjen e padisë është një kusht thelbësor për legjitimitetin e paditësit. Pala e paditur në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" për funksionimin e saj, ka të drejtë të vendosë gjoba dhe t'i japë rekomandime të gjithë institucionet shtetërore që të përmirësojnë legjislacionin dhe të nxjerrin akte ligjore si dhe rregullime specifike në fushat e tyre përkatëse. Pala e paditur, bazuar në sa më sipër, ka rekomanduar palën paditëse Ministrinë e Arsimit me vendimin nr. 14, date 29.01.2015 të përmirësojë aktet ligjore për sa i përket rastit konkret. Gjykata vlerëson se

Ministria e Arsimit është organi i cili merr iniciativën për ndryshimin dhe miratimin e ligjeve të reja dhe paketave ligjore në fushën e arsimit në Republikën e Shqipërisë. Nga vetë pala paditëse në ankimin e paraqitur është pohuar se Rregullorja e brendshme e shkollës duhet të përcaktojë normat e veshjes. Në rast se nuk ka rregullore të miratuara zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat normative, të miratuara me urdhër të Ministrit të Arsimit, të cilat përcaktojnë se veshja duhet të jetë në përputhje me normat e bashkëjetesës, ku në një ambient laik, veshja duhet të jetë laike. Pra është vetë pala paditëse në pretendimet e saj e cila pranon faktin se shkolla nuk ka një rregullore të miratuara, por sugjeron zbatimet e paketës ligjore, fakt ky që shkon me unison me rekomandimin e bere nga pala e paditur. Për rrjedhojë, vendimi nr. 14, datë 29.01.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i drejtohet pikërisht palës paditëse duke e rekomanduar atë në lidhje me përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë. Për rrjedhojë të sa më sipër, gjykata vlerëson se akti objekt shqyrtimi i drejtohet pikërisht palës paditëse Ministrisë së Arsimit, ndryshe nga sa ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, e për rrjedhojë, kjo palë ka legjitimitet aktiv për ta goditur këtë akt, pasi pasojat juridike që vijnë prej tij, vijnë pikërisht për palën paditëse, Ministrinë e Arsimit.

5. Kolegji Administrativ i Apelit vlerëson se vendimi nr. 14 datë 29.01.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i drejtë dhe i bazuar, ashtu si me të drejtë ka cmuar gjykata e shkallës së parë. Rezulton se nxënësja e Shkollës së Mesme të Përgjithshme [REDAKTUAR] në fillim të vitit shkollor 2013-2014, ka vendosur mbulesë, si element të besimit të saj mysliman. Nxënësja [REDAKTUAR] është paraqitur me mbulesë në ambientet e shkollës, ku është ndaluar të hyjë nga stafi i shkollës. Për rrjedhojë, nxënësja është ankuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ky i fundit, konkludoi se nga ana e Drejtorisë Arsimore Korçë - Shkollës së Mesme të Përgjithshme [REDAKTUAR] është kryer diskriminimi për shkak të bindjes fetare përkundrejtë nxënësës [REDAKTUAR]. Nëpërmjet vendimit Nr. 14, datë 29.01.2015, ky organ ka vendosur ndalimin e diskriminimit dhe lejimin e nxënësës të ndjekë rregullisht mësimin si nxënësit e tjerë. Gjithashtu në këtë vendimarrje është rekomanduar Ministria e Arsimit dhe Sportit që të amendojë ligjin për sistemimin parauniversitar për të hartuar akte ligjore dhe nënligjore më të sakta dhe më të qarta. Ky kolegji konstaton se nga gjykimi në shkallë të parë u pohua nga palët se nga organet e arsimit parauniversitar ka patur ndalim të shprehjes apo shfaqjes në mjediset e shkollës të elementeve të besimit mysliman nga nxënësja Rexhollari. Kolegji thekson se sipas nenit 18 të Kushtetutës, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit, parim i cili në rastin konkret është shkelur, pasi nxënësës [REDAKTUAR] i është ndaluar ndjekja e ciklit mësimor në një shkollë publike ku e drejta për arsim është e drejtë që iu përket të gjithë shtetasve shqiptar, qëndrim i mbajtur me të drejtë dhe nga gjykata e shkallës së parë.

6. Gjykata Administrative, në analizë të fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt gjykimi vlerëson jo të drejta pretendimet e ngritura nga pala paditëse dhe personi i tretë se nuk kemi të bëjmë me sjellje diskriminuese, pasi ekuilibri midis të drejtës për arsim në një shkollë publike dhe të drejtës për të shfaqur besimin fetar në mjediset e një shkollë publike është e normuar me ligj. Kjo gjykatë, ashtu si gjykata e shkallës së parë, thekson se neni 10 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: *“1. Ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së rriteve”*.

Gjykata analizon se lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një rrethanë të tillë e për rrjedhojë, gjykata vlerëson se duke i kërkuar nxënës qe, në mënyrë qe ajo të ndiqte arsimin parauniversitar, duhej të hiqte mbulesën, përbën ndërhyrje në të drejtën e saj për ushtruar lirinë e fesë, ashtu sic me të drejtë ka vlerësuar dhe gjykata e shkallës së parë. Duke qenë se ligji nuk ka parashikime për sa i përket raportit ndërmjet asaj qe quhet laike dhe asaj qe quhet veshje e përshtatshme për një nxënëse të arsimit parauniversitar, bëjnë qe ndalimi i nxënës për shkak të veshjes së saj, të jetë jo i drejtë dhe i pambështetur. Për rrjedhojë nga sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson e me të drejtë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka çmuar të bazuar vendimin nr. 14, date 29.01.2015 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

7. Gjykata Administrative e Apelit, çmon se procedura e zhvillimit të këtij gjykimi rezulton të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe ligjin 49/2012. Nuk konstatohen shkelje si në procedurën e zhvillimit të gjykimit edhe në procedurën e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë.

8. Kolegji Administrativ i Apelit, në analizë të ankimit të paraqitur nga pala paditëse, ndaj vendimit nr. 2665, datë 18.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane e në analizë të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural qe gjen zbatim në rastin konkret, çmon se: Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe atij material dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

8. Për të gjitha sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson tërësisht të pabazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim. pasi vendimi i Gjykatës Administrative të

Shkallës së Parë Tiranë, është marrë në analizë të plotë të rrethanave të faktit e të ligjit. Referuar nenit 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012, kjo Gjykatë vlerëson se duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 50 gërma "b" të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative",

VENDOSI

Lënie në fuqi të vendimit nr. 2665, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë brenda 30 ditëve duke filluar nga e nesërmyja e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 12.09.2017.

ANËTARE

Enkelejda METALIAJ(SOFTA)

d.v

ANËTARE

Alkelina GAZIDEDJA

d.v

KRYESUES

Arjan QAFA

d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari
Leonard Stenka
Rrethi

